



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 47, datë 20 .11. 2012

**PËR**

**“EMËRTIMIN “ÇAMËRIA” TË ISH FUSHËS SË SPORTIT QË NDODHET NË  
RRUGËN ALI DEMI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe nenit 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar)”, me propozim të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Tahir Muhedini përfaqësues i partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Çamëria” të ish fushës së sportit që ndodhet në rrugën “Ali Demi”, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë me emërtimin “Çamëria”, ish fushën e sportit që ndodhet në rrugën “Ali Demi”, pozicioni i së cilës është sipas hartës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**